



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 224, Datë 06.09.2022

MBI

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ALBPETROL” SH.A., NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 140, DATË 06.09.2017**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3, si dhe nenit 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; nenit 15 dhe nenit 19, pika 1 gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.09.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1510/2 prot., datë 02.09.2022, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “ALBPETROL” sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 140, datë 06.09.2017”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 180, datë 13.07.2022, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “ALBPETROL” sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- ERE bëri njoftimin në median e shkruar për këtë vendimmarrje, i cili është botuar në datat 15.07.2022 dhe 16.07.2022 dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve të mundshme nga të tretët (data e fundit 28.07.2022), nuk rezultojnë të ketë të tilla. Ndërsa me shkresën nr. 971/2 prot., datë 27.07.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën “Njoftim vendimi dhe kërkesë për plotësim dokumentacioni”.

- Në vijim të e-mailit të shoqërisë, protokolluar në ERE me nr. 971/2 prot., datë 08.08.2022, me anë të të cilit ka depozituar dokumentacion plotësues sikurse ka deklaruar se do të depozitojë në vijim dhe dokumentacion shtesë për këtë aplikim, bordi i ERE-s, me vendimin nr. 205, datë 10.08.2022, vendosi të shtyjë deri më 06.09.2022 afatin e vendimmarrjes së tij për rinovimin e licencës së shoqërisë “ALBPETROL” sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. ERE njoftoi shoqërinë për këtë vendimmarrje me shkresën nr. 970/2 prot., datë 22.08.2022, duke evidentuar dhe dokumentacionin e mbetur ende pa plotësuar.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr., 970/3 prot., datë 31.08.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacion/informacion plotësues për aplikimin dhe ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, në zbatim të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik dhe administrativ; Dokumentacionin financiar dhe fiskal; si dhe Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin në zbatim të nenit 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”, nenit 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”, nenit 9, pika 3 gërmat “a”, “c” dhe “d” si dhe nenit 9, pika 4.8, gërmat “a”, “b” dhe “c”.
- Në lidhje me dokumentacionin financiar shoqëria Albetrol sh.a., duhet të depozitojë në ERE bilancin financiar të vitit 2021 sikurse depozituar në organet tatimore deri më 31 mars 2022.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën nr. 381, seria T17 të shoqërisë “ALBPETROL” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 140, datë 06.09.2017, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 07.09.2022.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI